

Curri në Hoçë të Vogël/Mala Hoça. Merr-
ej me aktivitete humanitare dhe ishte i
respektuar nga banorët e fshatit. Në datën
24.05.1998, nga mesdita, Çausi shkoi
për të punuar në vreshtat e veta te vendi
i quajtur *Paskidal*, në afërsi të rrugës së
asfaltuar [**Hoça e Vogël/Mala Hoça**]. Nga
ora 17:00, komshinjtë e kanë gjetur trupin
e tij të pajetë në vreshtat e tij. Ishte që-
lluar me disa plumba në gjoks. Një ditë më
vonë, Çausin e kanë varrosur në varrezat
e fshatit. Disa ditë më vonë, policia e ka
bastisur shtëpinë e Çausit. Për këtë arsye,
e tërë familja Krasniqi e ka braktisur vendin
dhe ka shkuar në Gjermani.

Burimet: deklarata R.G, FDH-33487;
KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Sakip (Xhemajl) Bellaqa

(14.11.1964, shqiptar nga Drenoci/Drenovac,
komuna e Rahovecit/Orahovac, pjesëtar i UÇK-së)

Feim (Avdi) Gashi

(22.02.1971, shqiptar nga Drenoci/Drenovac,
komuna e Rahovecit/Orahovac, agronom, pje-
sëtar i UÇK-së)

Përparim (Ali) Thaqi

(30.06.1976, shqiptar nga Landovica, komuna e
Prizrenit/Prizren, student pedagogjie, pjesëtar
i UÇK-së)

Në datën **27.05.1998**, Feimi, Sakipi dhe
Përparimi e kanë marrë detyrën që t'i
bartnin disa armatime në shtabin e UÇK-
së në Drenoc/Drenovac. Rreth orës 22:15
apo 22:30, te vendi i quajtur *Përudhë*, i
cili gjendet mes fshatrave Xërxë/Zrze dhe
Bellacërkë/Bela Crkva, Feimi, Sakipi dhe
Përparimi kanë rënë në pusi të policisë
serbe. Që të tretë gjeten vdekjen në betej-
ë. Feimi dhe Përparimi janë varrosur në
varrezat e fshatit Drenoc/Drenovac. Saki-
pin e kanë varrosur në varrezat e fshatit
Potočan i Epërm/Gornje Potočane. Pas
përfundimit të luftës, më 15.09.1999,
mbetjet mortore të Përparimit janë rivarr-
osur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës
në Landovicë/Landovica.

Burimet: deklarata S.T, FDH-8897; KMDLNI,
Buletini, num. 7, prill-qershor 1998, 143,
FDH-23816; SHFUDUÇK, *Feniksët...*8, 75-80;
SHFUDUÇK, *Feniksët...*9, 219-223; J. Martinsen,

Regjistri..., FDH-26092.

Shaban (Rexhep) Shala

(22.08.1959, shqiptar nga Prizreni/Prizren,
sekretar në shkollë të mesme, katër fëmijë)

Gjatë viteve të nëntëdhjeta, Shabani ka
qenë anëtar i shquar i LDK-së në Prizren.
Për shkak të angazhimit politik, ka vuajtur
një vjet në burgjet e Prizrenit/Prizren dhe
Dubravës/Dubrava [Istog/Istok]. Pas lirim-
it nga burgju, e ka braktisur LDK-në. Ditën
e martë, më **2.06.1998**, Shabani me dy mi-
qtë e tij, Haki Morinën dhe Fadil Hotin,
kanë shkuar me makinën e Shabanit në
shtabin e UÇK-së në **Drenoc/Drenovac**.
Menjëherë pas arritjes së tyre, pjesëtarët të
UÇK-së e kanë futur Shabanin në bodrum-
in e shkollës fillore, e cila ishte afro 500
metra larg shtabit, ndërkaq miqve të tij u
thanë që të shkonin. Ditën tjetër, babai i
Shabanit, Rexhepi, ka shkuar në shtab për
tu interesuar për fatin e djalit. Në shtab i
thanë se Shabani ishte aty, por nuk i leju-
an që ta takonte të birin. Gjatë kësaj vizite,
Rexhepi e ka parë automobilin e Shabanit,
të parkuar përpara shtabit. Pas disa ditësh,
Rexhepi prapë shkoi në shtab. Një ush-
tar i tha se Shabanin, për shkak të ofen-
sivës serbe, e kishin transferuar në rajonin
e Drenicës/Drenica. Makina e Shabanit
ende ishte në të njëjtin vend. Pas datës
2.06.1998, Rexhepi kurrë më nuk e kishte
takuar të birin.

Gjykata Supreme e Kosovës, në muajin
prill të vitit 2009, e ka nxjerrë aktgjykimin
e plotfuqishëm me të cilën pjesëtarët e
policisë ushtarake Selim Krasniqi, Bedri
Zyberaj dhe Agron Krasniqi u dënuan me
burg shumëvjeçar për shkak të ndalim-
it të paligjshëm dhe trajtimit ç'njerëzorë
Shabanit dhe të burgosurve të tjerë, në
burgun e UÇK-së në Drenoc/Drenovac.

Në dhjetorin e vitit 2009, Komisioni për
Persona të Zhdukur i Qeverisë së Kosovës
e ka njoftuar zyrtarisht bashkëshorten e
Shabanit se, në korrikun e atij viti, në një
pyll pranë Malishevës/Mališevo, ishte gje-
tur koka e Shabanit dhe se me analizën e
ADN-së ishte konfirmuar identiteti i bash-
këshortit të saj. Familjarët kanë refuzuar që
t'i merrnin mbetjet mortore të Shabanit,